

2385
17.2.15



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 3876/117
Dt. Regj. 19.05.2014

Nr. Vendimi 62
Dt. Vendimi 21.01.2015

V E N D I M
"Ne emer te Republikes"

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues te perbere prej:

Kryesuese: Rilinda SELIMI
Anetare: Alkelina GAZIDEDJA
Anetare: Blerona HASA

me sekretare gjyqesore Afede RUNAJ, ne Tirane, sot me date 21.01.2015 shqyrtoi ne dhome keshillimi ceshtjen administrative nr. 3876 akti, dt. Regjistrimi 19.05.2014 qe u perket paleve ndergjyqese:

PADITES: Shoqeria "Mp-HEC" shpk, me seli ne Durres, Rrashbull, me NIPT K 93826001 D, me perfaqesuese Anna Xheka, me adrese njoftimi "Lagja 17, Rruga "Drejtesia" Durres.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korce

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Njoftim Vleresiit me nr. Prot.10487 date 09.07.2013 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korce per periudhen tatimore;
- Tatim fitimi per periudhen viti 2012

BAZA LIGJORE: Kodi i Procedurave Administrative, Ligji nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative", Ligji nr. 9920 dt. 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise",

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korce me vendimin nr. 165 date 08.04.2014 ka vendosur:
"1. Pranimin e padise.

2. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te "Njoftim Vleresimi Tatimor" nr. 10487 date 09.07.2013, nxjerre nga DRT Korce per periudhen tatimore viti 2012, per subjektin "MP-HEC" shpk, perkatesisht tatim fitimi ne Shumen 1.676.258 leke, kamatvones ne Shumen 57.032 leke dhe gjoba ne Shumen 756.817 leke, si akt I nxjerre ne kundershtrim me procedure e parashikuar nga ligji. Shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne Shumen 3.000 leke, I ngarkohen pales se paditur..."

Kunder ketij vendimi kane bere ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korce dhe Avokatura e Shtetit te Zyres Vendore Korce per ndryshimin e vendimit per shkaqet:

- Akti administrativ, Njoftim Vleresimi tatimor me nr. 10487 date 09.07.2013 eshte nxjerre nga DRT Korce si rezultat i diferencave te konstatuara ne pasqyrat financiare te bilancit te vitit 2012. Konkretisht, ka rezultuar se te ardhurat e pasqyruara ne pasqyrat financiare te bilancit per efekt te tatimfitimit kane diferenca me te ardhurat e situates financiare te sistemit informatik te DRT Korce. Nga subjekti eshte deklaruar 0 leke te ardhura ndersa ne situaten financiare te sistemit informatik per vitin 2012 rezulton me nje te ardhur ne vleren prej 16862576 leke, pra me nje difference 16.862.576 leke leke.
- Per kete parregullsi fillimisht tatimpaguesi eshte njoftuar me shkresen nr. 9477 date 12.06.2013 duke e sqaruar per mosperputhje te situates financiare te sistemit te informatikes dhe deklarimit online te deklarates se tatimfitimit per vitin 2012. Pas perfundimit te afatit te njoftuar me shkresen e dates 12.06.2013, Inspektori i Drejtorise se Perpunimit, Menaxhimit, Kontabilitetit te te Ardhurave ka nxjerre aktin njoftim vleresimi tatimor per te cilin nga paditesi kerkohet konstatimi i pavlefshmerise absolute.
- Tatimpaguese ka kundershtuar aktin e nxjerre nga DRT Korce dhe DAT me vendimin nr. 19805/1 prot date 24.12.2013 ka vendosur refuzimin e ankimit me argumentin e mosparapagimit te detyrimit dhe kamatvonesave, referuar nenit 107, pika 3 e ligjit per procedurat tatimore.
- Kundershtojme vendimin e gjykates e cila edhe pse i ka bere nje interpretim te ligjit procedural dhe ligjit material ka vendosur konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit te njoftim vleresimit tatimor. Gjate hetimit gjyqesor te aktit paditesi ka pretenduar qe akti administrativ eshte absolutisht i pavlefshem pasi ka dale ne kapercim te kompetences dhe ne shkelje te procedures.
- Ne lidhje me kompetencen e nxjerrjes se aktit gjykata ka vleresuar drejt dhe ka bere nje interpretim te hollesishem dhe te detajuar fakteve. Organi tatimor eshte organi qe administron tatimet dhe taksat e personave fizike dhe juridike qe ushtrojne aktivitet dhe realizojne te ardhura. DRT Korce ne respekt te ligjit material kur konstaton pasaktesi te deklarimeve, mospagesa ne afat apo cdo shkelje te legjislacionit tatimor, nxjerr njoftim vleresimi tatimor. Organi tatimor eshte organi kompetent i cili me te drejte pas konstatimit te pasaktesise ne deklarim ka nxjerre aktin administrativ njoftim vleresimi nr. 10487 date 09.07.2013.
- Ne interpretim te dispozitave ligjore neni 116 pika "c" referon nje akt administrativ do te quhet absolutisht i pavlefshem kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kundershtrim me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji. Nga provat e administruara ne gjykim rezultuan mosperputhje te dhenash te deklaruar nga shoqeria ne pasqyrat financiare te vitit 2012 me ato te deklaruar ne sistemin e informatikes se DRT Korce. Sipas gjykates organi tatimor ka shkelur proceduren ne nxjerrjen e aktit administrativ, meqenese ndaj shoqerise ishte kryer nje kontroll tatimor detyrimet e te cilit ishin evidentuar ne njoftim vleresimin me nr. 19727 date 03.09.2012. Gjithashtu, gjykata ka arsyetuar se me shkresen e dates 18.06.2013 perfaqesuesja ligjore e shoqerise ka sqaruar organin tatimor ne lidhje me diferencat e konstatuara. Kundershtojme vendimin e gjykates e cila ka vleresuar pretendimet e paditesit pasi sipas saj jane llogaritur detyrime tatimore per te njejten periudhe tatimore. Kontrolli i ushtruar ne subjekt ka konstatuar pasaktesi dhe ka nxjerre detyrimet perkatese, detyrime keto qe nuk jane paguar nga ana e shoqerise dhe me te drejte DRT Korce duke konstatuar mosperputhje te shifrave ne referim te nenit 68 te Ligjit 9920/2008 ka bere vleresimin tatimor nga zyra.
- Ka qene periudhe relativisht shume e gjate nga momenti i ushtrimit te kontrollit, detyrime te finalizuar ne njoftim vleresimin nr. 19727 daste 03.09.2012 dhe dates se nxjerrjes se njoftim vleresimit tatimor objekt gjykimi, ndaj shkresa e dates 18.06.2013 me te cilen shoqeria sqaron organin tatimor nuk mund te perbeje shkelje procedure ne nxjerrjen e aktit objekt gjykimi sikurse argumenton gjykata.

- ne kuptim te pikes "c" te nenit 116 te K.Pr.Administrative, forma dhe procedura e nxjerrjes se aktit eshte nje nder elementet qe percakton vlefshmerine e nje akti administrativ, por qe akti te konstatohet absolutisht i pavlefshem duhet qe shkelja e ligjit te jete thelbesore dhe flagrante. Shkalla e shkeljes se ligjit eshte kriteri dallues midis pavlefshmerise relative dhe absolute te aktit administrativ. Kjo gjen rregullimin ligjor edhe ne nenin 40, pika 4 ne te cilen parashikohet se "Gjykata vendos rrezimin e padise edhe kur vlereson se, pavaresisht shkeljeve proceduriale te konstatuara te veprimtarise administrative, pasojat do te ishin te njejta."
- procedura e nxjerrjes se aktit administrativ eshte e parashikuar ne ligjin material dhe nuk ndodhemi ne kushtet e shkeljes flagrante te ligjit per te sjelle pavlefshmerine absolute te aktit administrativ. Kundershtojme arsyetimin e gjykates pasi sipas saj nuk ndodhemi ne kushtet e nenit 68, pika 4 e ligjit material. DRT Korce nuk ka konkluduar apriori ne pasaktesine e deklarimit te detyrimit tatimor te bere nga ana e shoqerise, pasi vete shoqeria ka pasur pasaktesi ne deklarimet e bere ne bilancin e vitit 2012.
- Si konkluzion, duke ju referuar fakteve dhe provave dhe interpretimit te ligjit, ne zbatim te nenit 50, germes "c" te ligjit 49/2012, kerkojme ndryshimin e vendimit dhe lenien ne fuqi te aktit administrativ, njoftim vleresimit tatimor nr. 10487 date 09.07.2013 te DRT Korce.

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjqtares Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çeshtjen ne teresi;

V E R E N

Shoqeria paditese "MP-HEC" sh.p.k, eshte themeluar me date 23.02.2009 nga bashkimi i perkohshem i shoqerive DEVY shpk dhe Zyfi shpk, ne cilesine e koncensionarit pas lidhjes se kontrates se koncensionit me METE si autoritet kontraktues nr. 311 rep., nr. 45 kol date 02.02.2009. Shoqeria eshte regjistruar ne QKR me date 26.02.2009. Objekti i veprimtarise se saj eshte ndertim, operim dhe transferim i Hidrocentralit NICE nga Velcani te autoriteti kontraktues, perfshi financimin, ndertimin, venien ne pune, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjise elektrike ne zbatim te kontrates koncensionare.

Ortaket e kesaj shoqerie kane ndryshuar.

Me date 26.07.2010 ne baze te kontrates noteriale nr. 1206/444 eshte miratuar dhe regjistruar shitja e 10 % te kuotave te shoqerise KEFA shpk (Zyfi shpk) te ortaku tjetër DEVY shpk e cila ka vijuar ortake e vetme e shoqerise deri me date 30.07.2010, perfaqesuar nga administratori dhe ortaku i vetem i shoqerise DEVY shpk. Kjo pasi me vendimin e dates 26.07.2010 eshte shtuar si administratore znj Anna Xheka, administore e ortakut te ri te shoqerise Energy Albania Group shpk ne baze te kontrates se shitjes se 50 % te kuotave.

Midis dy administratoreve te shoqerise, njekohesisht administratore te ortakeve te saj ka patur mosmarreveshje. Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce me vendimin nr. 741-2013-139 (71) date 14.01.2013 ka pranuar kerkesen e shoqerise perfaqesuar nga administratore Anna Xheka per perjashtimin nga shoqeria te shoqerise tjetër ortake, tashme me emertimin "Kutrolli Nima shpk". Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendimin nr. 311 date 28.05.2013 ndersa me vendimin 00-2014-24 date 15.01.2014 Gjykata e Larte ka vendosur mospranimin e rekursit te paraqitur nga ortaku i perjashtuar.

Para ngritjes se kesaj padie per perjashtimin e shoqerise Kutrolli Nima" shpk (Devy shpk) administratorja Anna Xheka si nje nga administratoret e shoqerise, ne vitin 2012, ka kerkuar ushtrimin e nje kontrolli tatimor. Kontrolli rezultoi se ka perfshire :

- Tatim fitimi per periudhen shkurt 2009 – prill 2012,
- Tvsh per periudhen shkurt 2009 – prill 2012 dhe
- Tatime te tjera per periudhen shkurt 2009 – prill 2012.

Sipas raportit perfundimtar te kontrollit nr. 11500/3 prot. date 28.08.2012 dhe procesverbaleve shoqeruese, DRT Korce i ka njoftuar shoqerise Njoftim vleresimin tatimor nr. 19727 date 03.09.2012 rrjedhoje nder te tjera mbi vleresimin nga inspektoret tatimore te dokumentacionit per sherbimet e kryera nga shoqeria “Osmani”shpk faturuar shoqerise “Kutrolli Nima” shpk e me pas nga kjo e fundit shoqerise MP-HEC, referuar kontratave te lidhura nga administratori tjetër dhe te vleresuar ne procesin gjyqesor per perjashtimin e ortakut - shoqerise “Kutrolli Nima” shpk. Sipas inspektoreve faturat e blerjes se sherbimeve per realizimin e punimeve jane quajtur te pavlefshme si jo te bera ne kohen e duhur (te padeklaruara ne afat) duke vijuar me korigjimin e kreditimit te tvsh dhe vendosjen e penaliteteve.

Ne lidhje me ankimin e ketij akti rezulton nje tjetër proces gjyqesor, iniciuar me kerkesen e administratores A. Xheka depozituar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me date 08.02.2013 ne kushtet kur me vendimin nr. 21757 prot. date 07.01.2013 Drejtoria e Apelimit Tatimor kishte vendosur refuzimin e ankimit.

Me ane te vendimit nr. 204 akti date 12.07.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka pranuar kerkesen e administratores A. Xheka per rivendosje ne afat te ankimit te paraqitur prej saj me nr 48 prot. date 10.11.2012 ndaj njoftim vleresimit tatimor nr. 19727 date 03.09.2012 me arsyen se i ishte njoftuar vetem administratorit tjetër me te cilin ishte ne shqyrtim gjyqesor mosmarreshja tjetër, sipercituar. Vendimi rezulton te kete marre forme te prere si i paankimuar nga personi i trete, DAT.

Perpara marrjes se ketij vendimi gjyqesor, midis paleve ndergjyqese rezulton se:

- Me shkresen nr. 9477 prot. date 12.06.2013 DRT Korce njofton shoqerine se per vitin 2012 duhet te dorezonte brenda dates 30.03.2013 bilancin gje qe deri ne kete date nuk eshte bere, nderkohe qe sipas deklarimeve ne sistemin informatik rezulton me 16.862.576 leke te ardhura. Sipas kesaj shkrese, kerkohet qe brenda 10 diteve nga marrja e kesaj shkrese te dergohet bilanci ne te kundert do te procedohet me vleresim nga zyra.
- Ne pergjigje te kesaj shkrese rezulton shkresa e shoqerise me nr. 9 date 18.06.2013 sipas se ciles shoqeria shprehet se *“ eshte e vertete qe diferenca prej 16.862.576 leke ne te ardhurat financiare te tvsh nuk eshte pasqyruar ne pasqyrat financiare te vitit 2012 pasi eshte pikerisht diferenca qe ka rezultuar nga kontrolli i ushtruar ne subjekt me raport perfundimtar kontrollor nr. 11500/3 date 28.08.2012 te DRT Korce. Keto diferenca jane objekt i apelimit qe subjekti ka bere prane organeve kompetente me shkrese nr. 48 prot. date 10.11.2012 “kerkese per apelim tatimor”. Ceshtja eshte per gjykim ne Gjykatën e faktit Tirane, sipas kerkeses se depozituar ne kete gjykate me date 08.02.2013. Ne vijim shoqeria shprehet ne kete shkrese se sipas nenit 23 te K.Pr.Administrative, rezultatet e kontrollit te ushtruar ne subjekt sipas Raportit Perfundimtar te Kontrollit jane te pezulluara deri ne marrjen e nje vendimi perfundimtar te apelimit. Rrjedhimisht nuk mund te llogariten nga DRT Korce deri ne marrjen e nje vendimi perfundimtar. Ne kete shkrese shoqeria citon kerkesat e saj pa pergjigje per pajisjen me passwordin e shoqerise per deklarimet online.*
- Gjithashtu, kjo permbajtje rezulton edhe ne korespondencen ne fillim te muajit korrik. Keshtu, me date 01.07.2013 DRT Korce me shkresen nr. 10089 prot. u drejtohet te dy administratoreve se bilanci ekonomik per vitin 2012 eshte firmosur vetem nga njeri prej tyre, znj Anna Xheka, bilanc i cili nuk eshte i barabarte me situaten financiare te sistemit informatik, gje te per te cilen jane vene ne dijeni te dy administratorët. Ne fund te kesaj shkrese thuhet se “ neqofte se brenda pese diteve nga marrja e kesaj shkrese nuk dorezohet

bilanc i firmosur dhe i vulosur nga ana e te dy admnistratoreve, bilanci i derguar nuk do te quhet i vlefshme, do te behet vleresim nga zyra dhe do te zbatohen sanksionet perkatese”.

- Ne pergjigje te kesaj shkrese, administratorja A. Xheka me ane te shkreses nr. 10 prot. date 03.07.2013 kundërshton disa veprime te DRT Korce sipas te cilave kjo drejtori ka pranuar fatura dhe dokumente te tjere fiktive nenshkruar nga ish administratori i shoqerise dhe ortakut te perjashtur duke pajisur vetem kete te fundit me passwordin per deklarimet online. Ne lidhje me bilancin shprehet se shoqeria ka miratuar vetem bilancin per vitin 2013 me vendim te Asamblese dhe se per mosmiratim nga shoqeria nuk mund te merren parasysh bilancet e firmosura nga ish administratori per vitet 2010, 2011 dhe 2012 .

Ne lidhje me mosperputhjen e situates financiare te sistemit informatik, nga ana e administratorës parashtrohet serish se keto diferenca jane objekt i apelimit qe shoqeria ka bere ne DAT dhe se ceshtja ndodhet per gjykim ne lidhje me ankimin ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Me date 09.07.2013 DRT Korce i ka njoftuar shoqerise Njoftim Vleresimin Tatimor objekt i ketij gjykimi nr. 10487 prot. sipas te cilit shoqeria detyrohet me

- tatim fitimi viti 2012 ne shumen prej 1.676.258 leke, detyrim i papaguar
- kamatvonesa ne shumen 57.032 leke llogaritur nga STI
- gjobe 756.817 leke, per deklarim i pasakte i bilancit te vitit 2012

Gjithsej 2.490.107 leke.

Nxjerja e ketij akti arsyetohet nga DRT Korce mbi bazen e konstatimit se nga verifikimi i te dhenave te deklaruar nga shoqeria ne pasqyrat financiare te vitit 2012 te ardhurat e pasqyruara ne te per efekt te tatim fitimit kane diferenca me te ardhurat e situates financiare te sistemit informatik te DRT Korce. Nga shoqeria eshte deklaruar 0 leke te ardhura ndersa ne situaten financiare te sistemit informatik per vitin 2012 rezulton me nje te ardhur ne vleren 16.862.576 leke, pra me nje difference prej 16.862.576 leke.

Kerkesa ankimore e shoqerise ndaj ketij njoftim vleresimi daton me 04.11.2013 sipas se ciles pasqyrohet fakti se me njoftim vleresimin e dates 03.09.2012 eshte llogaritur tatim fitimi edhe per periudhen janar – prill 2012. Shoqeria shprehet se, “nga prilli 2012 deri ne nentor 2013 shoqeria MP-HEC shpk nuk ka asnje aktivitet dhe nuk ka kryer asnje veprim dhe as ka realizuar asnje te ardhur. Aktiviteti eshte i bllokuar. Nderkohe pavaresisht kesaj suate, DRT Korce nxjerr nje njoftim vleresimi te dyte, pra per te njejten periudhe kohore, ne kundërshtim te hapur me nenin 85 te Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, kjo drejtori ka nxjerre dy urdhra vleresimi me shifra te ndryshme detyrimesh, nderkohe qe njoftim vleresimi i pare gjendet ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.”

Sipas shoqerise, keto veprime jane ne shkelje te Kodit te Procedurave Administrative, nenet 116 dhe 117 dhe ligjit per procedurat tatimore, nenet 85, 89, 90 dhe 91 duke pretenduar se akti eshte nxjerre ne kapercim te kompetencave dhe ne kundërshtim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji.

Ne datën 11.11.2013 daton kerkesa e shoqerise drejtuar DAT “per informacion ne lidhje me vendimin e Drejtorise se Apelimit per apelin me nr. 48 prot. date 10.11.2012 “kerkese per apelim tatimor si dhe nr. 16 prot. date 04.11.2013”, keto per ankimin e Njoftim Vleresimit Tatimor te pare me nr. 19727 date 03.09.2012.

Me vendimin nr. 19205/1 prot. date 24.12.2013 Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur refuzimin e ankimit te shoqerise ndaj njoftim vleresimit nr. 10487 date 09.07.2013 per mosplotesimin e kushtit te parapagimit te detyrimit.

Mbi pretendimet parashtruar edhe ne ankimin administrativ, shoqeria ka depozituar padi ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Korce per konstatimin e pavlefshmerise absolute te njoftimit vleresimit nr. 10487 date 09.07.2013.

Shoqeria pretendon se kontrolli tatimor i meparshem ne baze te te cilit ka dale njoftim vleresimi nr. 19727 date 03.09.2012 ka perfshire periudhen janar – prill 2012 duke nxjerre detyrimet perkates dhe se ne vijim shoqeria e ka pasur dhe ka te bllokuar totalisht aktivitetin e saj dhe nuk ka kryer asnje veprim dhe nuk ka realizuar asnje te ardhur. Nderkohe qe ky njoftim ka qene ne proces apelimi, me date 01.11.2013 ka rene ne dijeni te njoftim vleresimit te dyte, objekt i kesaj padie qe referohet prej saj se eshte mbeshtetur pikerisht ne rezultatet e nxjerra sipas Raportit perfundimtar te kontrollit dhe procesverbaleve 8 dhe 9 qe shoqerojne ate, objekt apelimi tatimor.

Pra, nxjerrja e njoftim vleresimit eshte bere ne shkelje te procedures per shkak se nxjerrja e ketij akti varej nga vendimi paraprak i DAT ne lidhje me ankimin e njoftim vleresimit te pare. Vetem pas shprehjes nga organet e kontrollit te ligjshmerise se ketij njoftim vleresimi DRT Korce perligjej te bente rivleresimin e situates se re nga pikepamja fiskale, ne referim te nenit 23 te K.Pr.Administrative.

Shoqeria pretendon se ka dorezuar bilancin e vitit 2012 dhe deklaraten vjetore me shkrese nr. 3 prot. date 30.03.2012, pra nuk jemi perpara rastit te vleresimit nga zyra sikurse rregullon pika 63.31.c e Udhhezimit nr. 24/2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”. Gjithashtu, sipas shoqerise nuk ekziston as shkaqet per metodat alternative te vleresimit. Sipas shoqerise kemi te bejme me tejkalim te kompetencave nga ana e DRT Korce pasi nuk jemi as perpara rasteve te vleresimit nga zyra dhe as perpara rastit te perdorimit te metodave alternative te vleresimit.

DRT Korce bashkuar me te edhe Avokatura e Shtetit ka kerkuar rrezimin e padise me pretendimet se;

- inspektori i Drejtorise se Perpunimit, Menaxhimit dhe Kontabilitetit te te Ardhurave ka nxjerre njoftim vleresimin objekt kundershimi duke qene se subjekti kishte deklaruar 0 leke te ardhura ndersa ne situaten financiare te sistemit informatik per vitin 2012 rezulton me te ardhur ne vleren 16.862.576 leke.
- Ky njoftim vleresimi nuk ka dale bazuar ne rezultatet e kontrollit tatimor sikurse pretendon paditesi, por bazuar ne pasqyrat financiare te vitit 2012 te vetdeklaruara dhe depozituar ne organin tatimor.
- Nuk kane baze pretendimet e paditesit ne lidhje me apelimin e njoftim vleresimit te pare nr. 19727 date 03.09.2012 dale ne baze te rezultateve te kontrollit. Ky akt edhe nese eshte ankimuar ne organin me te larte administrativ nuk ka lidhje me detyrimet objekt gjykimi pasi keto detyrime kane dale nga zyra ne zbatim te nenit 68 pika 4 e ligjit nr. 9920/2008.
- Pra nuk jemi ne kushtet e nje kontrolli tatimor sipas parashikimit te nenit 85 te ligjit dhe as ne kushtet kur organi tatimor duhet te pezullonte procedimin perkates sikurse parashikon neni 23 i K.Pr.Administrative.
- Administrata tatimore ka kompetence te beje nje vleresim tatimor ku sipas pikes 68.3.1 te Udhhezimit nr. 24/2008, germa b, percaktohet rasti kur organi tatimor veren se detyrimi tatimor i dhene ne deklaraten tatimore eshte i pasakte, vleresim i cili bazohet ne informacionin qe permban deklarata tatimore e tatimpaguesit.
- Me shkresen nr. 9477 date 12.06.2013 me lende “Kerkese sqarimesh per diferencat e konstatuara ne bilancin e vitit 2012 i jane kerkuar shoqerise spjegime ne lidhje me diferencat e konstatuara. Pas skadimit te afatit te njoftuar me shkrese, DRT Korce ka nxjerre njoftim vleresimi tatimor. Pretendimi se nuk eshte pritur vendimi i DAT per njoftim vleresimin nr. 19727 date 03.09.2012 nuk qendron pasi keto akte nuk jane te ndervarura.
- Shkalla e shkeljes se ligjit eshte kriteri dallues qe ne dallimin midis akteve absolutisht te pavlefshme dhe akteve relativisht te pavlefshme. Sa me siper gjen rregullim edhe ne nenin 40,

pika 4 ne te cilen parashikohet se "Gjykata vendos rrezimin e padise edhe kur vlereson se, pavaresisht shkeljeve procedurale te konstatuara te veprimtarise administrative, pasojat do te ishin te njejta."

Ne perfundim te gjykimit, me vendimin nr. 165 date 08.04.2014 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korce ka vendosur per pranimin e padise. Gjykata ka cmuar se;

"ne daten 05.07.2013 inspektoret e Drejtorise se Perpunim Kontabilitetit, Sektori i Perpunim Vleresimit kane mbajtur procesverbalin per rivleresimin e deklarates se tatimfitimit te vitit 2012, ku te ardhurat nga 0 leke te deklaruar jane shenuar 16.862.576 leke. Ne kete procesverbal permbahet i shprehur fakti se te dy administratore e shoqerise ju eshte derguar shkrese per shkak te konfliktit mes tyre, ku jane vene vec e vec ne dijeni per mosperputhjen e situates financiare dhe deri ne daten e procesverbalit subjekti nuk ishte pergjigjur me ndonje shkrese.

Perkundrejt permbajtjes se ketij procesverbali perfaqesuesja ligjore e shoqerise gjate gjykimit pretendoi se pergjigja eshte kthyer me shkrim brenda afatit ligjor te caktuar nga marja dijeni, duke depozituar shkresen kthim pergjigje e mbi kerkimin e gjykates, pas verifikimit te dokumentacionit prane DRT, nga perfaqesuesja e pales se paditur u pranua dhe u depozitua ne cilesine e proves shkresa nr. 9 prot. date 18.06.2013 e perfaqesueses ligjore te paditesit e cila konfirmohet te jete mare nga pala e paditur ne daten 21.06.2013.

...ne analize te sa me siper, shihet qarte se pala e paditur, ne kundersiztim me rrethanat faktike te gjendjes se dokumentacionit qe lidhet me korespondencen e saj me subjektin e ne kushtet kur shkresa e perfaqesueses ligjore ka qene e depozituar ne DRT brenda afatit te caktuar, sipas nenit 60.3.1 te Udhhezimit nr. 24 date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore", ne kundersiztim me kete gjendje fakti eshte vijuar me mbajtjen e procesverbalit date 05.07.2013 duke marre te mireqena te dhenat ne emer te shoqerise ne sistemin informatik e duke vijuar mandej me llogaritjen e detyrimeve tatimore, perkatesisht tatim fitimi, gjobe dhe kamatvones.

Duke analizuar te dhenat e akteve te mesiperme, gjykata vjen ne konkluzionin se pala paditese ka permbushur detyrimin ligjor qe i buron nga neni 60 i ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 pasi ka dhene sqarime me shkrim per informacionin e kerkuar nga administrata tatimore, i cili sic u provua gjate gjykimit, nuk eshte shqyrtuar dhe vleresuar nga pala e paditur, por eshte vijuar me nxjerrjen e njoftim vleresimit.

Eshte fakt se ndaj shoqerise ishte kryer nje kontroll i finalizuar me raportin e kontrollit nr. 11500/3 date 28-08.2012 mbi bazen e te cilit kane dale detyrimet tatimore me njoftim vleresimin nr. 19727 date 03.09.2012 ku eshte kontrolluar periudha tatimore shkurt 2009 – prill 2009 dhe per kete periudhe jane llogaritur detyrime tatimore, tatim fitimi, tvsh dhe tatime te tjera. Nderkohe, ndonese periudha tatimore janar 2012 – prill 2012 ishte pjese e ketij kontrolli dhe vleresimi tatimor, pala e paditur ka llogaritur perseri tatim fitimi per te gjithe vitin 2012. Nga ana tjeter, perfaqesuesja e shoqerise ka pretenduar se prej muajit prill 2012 shoqeria nuk ka zhvilluar asnje aktivitet financiar dhe nuk ka prere fatura tatimore e per kete arsye deklarimi i te ardhurave ne bilanc eshte bere ne vleren 0.

Referuar sa me siper, gjykata cmon se pala e paditur, persa kohe ka kerkuar sqarim me shkrim nga tatimpaguesi per gjendjen e pasqyrave te tij financiare e ne kushtet kur realisht e ka patur te derguar ne kohe kete informacion, ka vepruar ne kundersiztim flagrant me proceduren, duke cenuar drejtperdrejt interesat e shoqerise ne cilesine e tatimpaguesit.

Pala e paditur nuk i ka patur kushtet ligjore te parashikuara nga neni 68 pika 4 e ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 per te konkluduar apriori se detyrimi tatimor i dhene ne deklaraten tatimore ka qene i pasakte, apo tatimpaguesi nuk ka dorezuar deklarate tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor e per rrjedhoje njoftim vleresimi i detyrimeve tatimore perfaqeson nje akt administrativ absolutisht te pavlefshem sipas nenit 116/c te Kodit te Procedurave Administrative.

Ne kundërshtim me sa pretendohet nga përfaqësuesit e palës së paditur, gjykata cmon se nuk jemi në kushtet e nenit 40, pika 4 e ligjit nr. 49/2012 pasi cenimi i procedurës përben shkelje thelbësore të ligjit që ka ndikuar drejtperdrejt në nxjerrjen e aktit dhe nuk mund të konkludohej apriori se DRT do të nxirrte të njejtin njoftim vlerësimi nëse do të kishte shqyrtuar dhe vlerësuar informacionin me shkrim të dhënë nga subjekti.

Gjykata ka cmuar të pabazuar pretendimin e shoqërisë së akti administrativ është nxjerrë në kapërcim të kompetencave me arsyetimin se “drejtorite rajonale tatimore në bazë të ligjit janë organet e ngarkuara për llogaritjen e detyrimeve tatimore dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimeve.”

Duke konfirmuar argumentet prapësues në gjykimin në shkallë të parë, pala e paditur DRT Korce dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korce kanë bërë ankim ndaj këtij vendimi, duke kërkuar prishjen e tij dhe lenien në fuqi të njoftim vlerësimit tatimor. Ankimet janë pranuar me vendimet përkatëse të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korce, ndërsa nga ana e shoqërisë është paraqitur apel kundërshtues.

Në keto rrethana ligjore e faktike të regjistrimit të ceshtjes, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit mori në shqyrtim ceshtjen në dhomë keshillimi, duke vlerësuar paraprakisht se ankimet e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit plotësojnë kushtet ligjore të pranueshmerisë për shqyrtim.

Ne vlerësim të shkaqeve të ankimit dhe analize të materialeve të ceshtjes, Kolegji Administrativ i Apelit cmon të cënueshem përfundimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korce në vendimi objekt ankimi nr. 165 datë 08.04.2014 se akti administrativ njoftim vlerësimit tatimor nr. 10487 prot datë 09.07.2013 nxjerrë nga i padituri Drejtoria Rajonale Tatimore Korce është absolutisht i pavlefshëm në veshtrim të nenit 116 të K.Pr.Administrative.

Në këtë dispozitë parashikohet se:

“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptim të këtij Kodi në rastet e mëposhtme:

- a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar.*
- b) Kur akti administrativ është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.*
- c) Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën ose procedurën e kërkuar nga ligji”.*

Në shqyrtimin e ligjshmerisë së vendimit, Gjykata Administrative e Apelit mban në konsideratë Vendimin Unifikues nr. 3, datë 12.02.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe qëndrimin e konsoliduar se

Nëse me anë të padisë kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, nuk është e detyrueshme të ezaurohet me parë rruga administrative e ankimit. Në këtë rast, objekt i gjykimit konsiston në vertetimin ose jo të njerit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për nulitetin e aktit administrativ pasi, sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative “*secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm.*”

Në rastin konkret, me anë të vendimit objekt ankimi gjykata e shkallës së parë ka cmuar se njoftim vlerësimi tatimor nr. 10487 prot. datë 09.07.2013 është nxjerrë në kundërshtim me rrethanat e faktit të sqaruara nga ana e shoqërisë me anë të shkresës nr. 9 prot. datë 18.06.2013 duke përmbushur detyrimin ligjor që i buron nga neni 60 i Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Kolegji cmon të gabuar këtë përfundim të gjykatës së shkallës së parë, cilesuar prej saj si rrethane që përben shkelje të procedurës së nxjerrjes së aktit objekt padie.

Eshte konsoliduar qendrimi se respektimi i formes dhe i procedures per nxjerrjen e aktit administrativ perben nje element shume te rendesishem, i cili percakton vlefshmerine e tij. Shkelja e procedures duhet te jete e atij karakteri dhe asaj rendesie qe te kete ndikuar drejtperdrejt ne nxjerrjen e aktit administrativ. Si rregull i pergjithshem, nje akt administrativ nuk eshte i papranueshem per mosrespektim te nje kerkese formale ose procedurale, ne rast se nje shkelje e tille nuk do te jepte ndonje ndryshim ne vendim.

Ne vijim te ketij qendrimi juridik, Kolegji vlereson se pavlefshmeria absolute e aktit administrativ nuk lidhet me menyren e gabuar te vleresimit nga organi tatimor te dokumentacionit tatimor te tatimpaguesit. Keto rrethana passjellin shfuqizimin e aktit pasi konsistojne ne shkaqe te pavlefshmerise relative. Te tille vlereson Kolegji arsyetimin e gjykates se shkalles se pare se *'ne kundërshtim me kete gjendje fakti eshte vijuar me mbajtjen e procesverbalit date 05.07.2013 duke marre te mireqene te dhenat ne emer te shoqerise ne sistemin informatik e duke vijuar mandej me llogaritjen e detyrimeve tatimore perkatesisht tatimfitimi dhe gjobe'* dhe se *"...ky informacion nuk eshte shqyrtuar dhe vleresuar nga pala e paditur, por eshte vijuar me nxjerrjen e aktit"*

Rezulton se nga ana e organit tatimor te paditur eshte konstatuar mosperputhja e te dhenave te deklaruar nga shoqeria ne pasqyrat financiare te vitit 2012 me te ardhurat e situates financiare te shoqerise rezultuar sipas sistemit informatik.

Veprimet e organit tatimor rezultojne te jene ndermarre duke njoftuar paraprakisht shoqerine per dorezimin e bilancin per vitin 2012 " i firmosur dhe i vulosur nga ana e te dy administratoreve". Nga ana e shoqerise behet me dije se ka te miratuar vetem bilancin per vitin 2013 me vendim te Asamblese dhe se per mosmiratim nga shoqeria nuk mund te merren parasysht bilancet e firmosura nga ish administratori per vitet 2010, 2011 dhe 2012.

Pra, rezulton se nga ana e organit tatimor rezultojne te jete vepruar me "vleresim nga zyra" ne kushtet e mosdorezimit sipas formes se kerkuar dhe brenda afatit te caktuar te bilancit per vitin 2012 i cili te argumentonte te dhenat e rezultuara ne sistem sipas deklarimit te shoqerise. Kjo, persa kohe kane rezultuar mosperputhje te te ardhurave te njohura ne dokumentacionin tatimor te shoqerise me ato te deklaruar ne organin tatimor per efekt te tatimit mbi fitimin per kete periudhe tatimore, sikurse urdheron (nder te tjera) neni 64 i ligjit dhe akti nenligjor ne fuqi; VKM nr. 55 date 03.02.2010 "Per deklarimin e detyrueshem te deklarateve tatimore dhe dokumenteve te tjere tatimore, vetem nepermjet formes elektrotonike" te ndryshuar.

Sa me siper cmohet ne ushtrim te pergjegjesive te organit tatimor sipas nenit 68 te ligjit 9920/2008 ku thuhet se *"Nese administrata tatimore veren se detyrimi tatimor i dhene ne deklaraten tatimore eshte i pasakte apo tatimpaguesi nuk ka dorezuar deklaraten tatimore, apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore ben vleresimin tatimor."*

Ne vijim te ketij arsyetimi, Kolegji cmon te gabuar cilesimin e pales paditese se nga ana e organit tatimor nuk mund te kryhej rikontroll tatimor, pasi nuk jemi ne kushtet e nenit 85 te ligjit.

Kolegji cmon se shkresa e dates 18.06.2013 me te cilen shoqeria sqaron organin tatimor nuk mund te perbeje shkelje te procedures ne nxjerrjen e aktit sikurse argumenton gjykata ne vendimin objekt ankimi, per shkak se vlereson se edhe nese njoftim vleresimi tatimor nr.10487 date 09.07.2013 do te ishte nxjerre ne nje periudhe te mevonshme sipas pretendimit te pales paditese pasi DAT te kishte nxjerre vendimin ne lidhje me aktin nr. 19727 date 03.09.2012, perfundimi do te ishte i njejte dhe akti do te permbante te njejtin detyrim tatimor.

Mbi argumentet si me siper, Kolegji Administrativ i Apelit konkludon te ndryshoje vendimin e Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Korce pasi cmon se pretendimet e paditesit jane te papazuara ne prova dhe ne ligj.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur ne nenin 50, germa "c" te Ligjit nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative",

V E N D O S I

1. Ndryshimin e vendimit nr. 165 date 08.04.2014 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Korce.
2. Rrezimin e padise.
3. Kunder vendimit lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte brenda 30 diteve nga e nesermja e njoftimit te tij.

U shpall ne Tirane, sot me 21.01.2015.

ANETARE
Alkelina GAZIDEDJA
DV

ANETARE
Blerona HASA
DV

KRYESUESE
Rilinda SELIMI
DV

E NJESUAR ME ORIGJINALIN
KANCELARI
LEONARD STRATAJ

